

Pranimi / Dorezimi / Prilipi / Protokol / Received / Delivery	18.01	2	viti / god. year
Organ / Agjencia / Organ / Udhëtimi / Org. Unit	In Prot. No. Prot. No.	Shtesa / Prilog. Appendix	Sasia / Kopësia / Quantity
SKPMSHCK	204/2022		1/3

## Republika e Kosovës

### Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1198/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1198/2021 të datës 20.12.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike “Kompensim material” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.01.2022, mori këtë:

#### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1198/2021 të datës 20.12.2021 të parashtruar nga ankuesi

#### A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Policinë e Kosovës respektivisht Stacionin Policor në Zubin Potok, përmes emailit [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) më datë 17.12.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më datë 20.12.2021 me numër të ankesës A.nr.1198/2021 dhe Nr. Prot: 6228/2021, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e shtesës materiale për periudhën Tetor-Dhjetor 2020, sipas pakos emergjente COVID-19.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Policia e Kosovës. Këshilli, me datë 14.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Policia e Kosovës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën me Nr.Prot:6228/2021 të regjistruar me numër A.nr.1198/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Listën e pushimeve në emër të ankuesit;



Ankesën lidhur me vendimin e pranuar më datë 05.05.2021 nga ankuesi për Bordin e Ankesave e datës 12.05.2020 për ankuesin; Listën e pagave në emër të ankuesit; Ankesën e datës 14.10.2021 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Ankesa; Njoftim-Shqyrtimit i ankesës në nivel lokal e datës 25.03.2021; Vendimin e datës 23.04.2021; Vendimin e datës 01.12.2021 i Komisionit Disiplinor i Policisë së Kosovës; Emailin e datës 17.12.2021 nga ankuesi; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 14.01.2022; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar e datës 11.09.2015 në emër të ankuesit; Emailin e datës 16.11.2020 nga F.A për D.D; Listën e zyrtareve të angazhuar në muajin tetor-dhjetor 2020; Emailin e datës 21.12.2020 nga O.T-K për D.D; Emailin e datës 21.12.2020 nga I.A për O.T-K; Emailin e datës 21.12.2020 nga D.D; Kërkesën për plotësim të listave të personelit policor për muaji Tetor dhe Nëntor 2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës, respektivisht Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës 11.09.2015 të ankuesit, ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës "Radio komunikues" në kuadër të Policisë së Kosovës respektivisht në Stacionin Policor në Zubin Potok, dhe i njëjti sipas kontratës se punës kryen këto detyra të punës: *I pranon dhe i shpërndan informata hyrëse dhe dalëse nga zyra e komunikimit. Kujdeset për regjistrimin, sistemin dhe shpërndarjen e informatave. Mban shënime dhe kujdeset për veprimet e patrullave. Pranon të gjitha thirrjet dhe i shpërndan informatat. Angazhimi për mbajtjen e komunikimit të nevojshëm me Departamentit/Drejtoritë dhe njësitë tjera të Policisë së Kosovës. Mban kontakt me institucionet e ndryshme brenda territorit që kujdeset stacioni apo njësia. Kujdeset për sigurimin e të dhënave të kërkuara për njësitë patrulluese në terren. Bënë verifikimin e personave të dyshuar në listat përkatëse. Bënë verifikimin e veturave (për regjistrim, vjedhje, aksident etj). Kryen edhe punë tjera që ja përcakton mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të cilat me arsye mund të kërkojnë kohë pas kohe e të cilat nuk cenojnë dinjitetin e punonjësit.*

Lidhur me pranueshmerinë e ankesës Kolegji analizoi dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunës civil* - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë: 6. *Nëpunës administrativo-teknik* - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike, dhe si rrjedhojë duke u bazuar në përkrahjen e detyrave të punës të ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se pozita "Radio komunikues" hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, respektivisht ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi ka statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e





Ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1198/2021 te datës 20.12.2021 të parashtruar nga ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës, dhe sipas 24 paragrafi 4 të këtij ligji, zyrtarët publik me status të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës, përmes Vendimit Nr.KDNSHC-05/063/2021 të datës 01.12.2021 është shpallur jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit dhe ka udhëzuar palën në ushtrimin e mjeteve juridike në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në rrethanat si me lartë, vlerëson se Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil në Policinë e Kosovës gabimisht ka udhëzuar palën lidhur me të drejtë e ushtrimit të mjeteve juridike, sepse kompetent për shqyrtimin e ankesës është Komisioni i Ankesave në kuadër të organit të punësimit ashtu siç përcaktohet me nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1198/2021

Avdyl BEKTESHI

  
Procesmbajtës

Jeton KOÇA  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

